



Prishtinë, 29 prill 2014
Kodi i ZRRE-së: V_618_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lumëbardhi i Pejës që përbëhet prej (5) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I 4.6 MW, HC Drelaj II 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW HGU Rugova 40.5 MW, me kapacitet total prej 60.5 MW, në komunën e Pejës, të datës 24.06.2013 të shoqërisë “KelKos Energy Peja” SH.P.K., me adresë “Ahmet Krasniqi” Blloku C1/b,15., Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 29 prill 2014 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I.** Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se shoqëria “KelKos Energy Peja” SH.P.K., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji në Lumin Lumëbardhi i Pejës që përbëhet prej (5) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I 4.6 MW, HC Drelaj II 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW HGU Rugova 40.5 MW, me kapacitet total prej 60.5 MW, KK Peja.
- II.** Aplikantit “KelKos Energy Peja” SH.P.K., mund t’i lëshohet **AUTORIZIMI** për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III.** Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese para se t’i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV.** Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar, i lëshohet shoqërisë “KelKos Energy Peja” SH.P.K., për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të bëjë kërkesë me shkrim duke kërkuar që ti lëshohet Autorizimi për ndërtim të stabilimenteve të reja gjenerues nga Uji.



Arsyetim

- ZRRE me datë 24.06.2013 nga shoqëria “**KelKos Energy Peja**” **SH.P.K.**, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lumëbardhi i Pejës që përbëhet prej (5) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I 4.6 MW, HC Drelaj II 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW HGU Rugova 40.5 MW, me kapacitet total prej 60.5 MW, KK Peja.
 - Njëra prej njësive të aplikacionit në fjalë është edhe HC Kuqishtë 4.5 MW, e cila është e përfshirë edhe në Vendimin për Autorizimin preliminar V-497/2013 të datës 23.01.2013 për ndërtim të hidrocentralit në lokacionin Kuqishtë, me kapacitet 3.1 MW, KK Peja, e cila i është lëshuar “RIMED” N.T.Sh. ZRRE në bazë të dëshmive të aplikacionit ka konstatuar se koordinatat e këtyre dy projekteve janë të ndryshme, por në rast të kundërt, sqarimi përfundimtar lidhur me lokacionin e tyre do jepet me **Lejen Ujore të MMPH**.
 - ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura aplikacionit dhe pranimit të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar